




		REPUBLIKË E KOSOVËS REPUBLIC OF KOSOVO	
		AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.		Nr. Prot.	<u>01-4008/14</u>
Dep.		Bi. Prot.	
Dep.		Prot No.	
Nr. I faq.	<u>2-0/DPK</u>	Data	
Broj stranica	<u>02</u>	Datum	<u>07.11.2014</u>
Nr. pages		Date	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI – CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 (parografi 1.1), nenit 5 (parografi 1 pika 1.5), nenit 18 (parografi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (parografi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 06.11.2014, mori:

V E N D I M

I. Mbylljet rasti me nr. AKK – 03-1689/14, për z. Agim Kukaj – Udhëheqës i Departamentit të Postë Telekomunikacionit dhe Teknologjisë Informatike në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, për shkak se zyrtari i lartë publik kashmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funksionit Publik, nr. AKK – 03-1689/14, për z. Agim Kukaj – Udhëheqës i Departamentit të Postë Telekomunikacionit dhe Teknologjisë Informatike në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik(më tutje: LPKI).

Në këtë rast zyrtari i lartë z. Kukaj është hetuar për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, si zyrtar i lartë në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik dhe njëkohësisht person i autorizuar në biznesin privat “Mobil-electronic”d.o.o.

Zyrtari i lartë fillimisht është njoftuar me shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e procedurës së shqyrtimit të gjendjes së konfliktit të interesit, ndërsa më pas është kontaktuar nga zyrtarët e Agjencisë për t'i sqaruar situatën në të cilën ndodhet, në mënyrë që të shmangë situatën e konfliktit të interesit.

z. Kukaj i janë dhënë rekomandimet për kufizimet si menaxher në biznesin privat, mirëpo ai nuk i ka përfillur këto rekomandime. Kjo me arsyetimin se, sipas tij, ai nuk është më person i autorizuar në këtë biznes. Mirëpo, në bazë të të dhënave zyrtare, të siguruara nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë, është konstatuar e kundërta.

Prandaj, Agjencia kundër Korruptionit, konform nenit 18 (paragrafi 5) të Ligjit PKI, zyrtarit të lartë, z. Kukaj, i ka bërë edhe shkresën e dytë (paralajmëruese) në të cilën e ka njoftuar për situatën në të cilën ndodhet dhe për masat tjera që mund të pasojnë, nëse gjendja nuk ndryshon dhe njëkohësisht i ka dhënë afat të ri, por të kufizuar ligjor, për ta ndryshuar këtë gjendje duke shmangur konfliktin e interesit.

Ndërkohe z. Kukaj ka njoftuar Agjencinë se ka bërë ndryshimet e nevojshme për shhangjen e konfliktit të interesit. Kjo është vërtetuar edhe me shkresën zyrtare të lëshuar nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPKI 03 - 3928/14), në bazë të së cilës zyrtari i lartë Agim Kukaj nuk është më person i autorizuar në biznesin privat "Mobic-electronic" d.o.o.. Me këtë ka shmangur situatën e mundshme të konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./zpj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtor i Agjencisë kundër Korruptionit

Hasan Preteni

